

I. KËRKESAT MINIMALE PËR LËSHIMIN E LEJEDREJTIMIT

Për tu pajisur me lejedrejtimi kandidati (vendas ose i huaj) duhet:

- a) të plotësojë kërkesat e moshës minimale;
- b) të plotësojë kërkesat psiko-fizike;
- c) të kryejë programin e plotë teorik dhe praktik për drejtues mjete në një autoskollë, përveç kategorisë AM që merret vetëm me provë teorie;
- d) të kryejë trajnimin mbi dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti rrugor, kur pajisesh me lejedrejtimi për herë të parë;
- e) të fitojë provat për drejtues mjete (provën teorike dhe/ose provën e aftësive drejtuese e të sjelljes) për kategorinë e kërkuar.

a) të plotësojë kërkesat e moshës minimale

Tab. 04

Kategoria	Mosha Minimale	Eksperienca
AM	16 vjeç	Merret vetëm me provë teorie
A1	18 vjeç	
A2	18 vjeç	
A	20 vjeç	Merret, të paktën, 2 vjet pasi të jetë marrë lejedrejtimi e kategorisë A2
B1	18 vjeç	
B	18 vjeç	Kategoria B me kodin 96, merret, të paktën, 1 vit pasi të jetë marrë lejedrejtimi i kategorisë B në moshën 19 vjeç
BE	19 vjeç	Merret të paktën, 1 vit pasi të jetë marrë lejedrejtimi i kategorisë B
C1	19 vjeç	Merret, të paktën, 1 vit pasi të jetë marrë lejedrejtimi i kategorisë B
C1E	20 vjeç	Merret, të paktën, 1 vit pasi të jetë marrë lejedrejtimi i kategorisë C1
C	21 vjeç	Merret, të paktën, 3 vjet pasi të jetë marrë lejedrejtimi i kategorisë B
CE	22 vjeç	Merret, të paktën, 1 vit pasi të jetë marrë lejedrejtimi i kategorisë C
D1	22 vjeç	Merret, të paktën, 1 vit pasi të jetë marrë lejedrejtimi e kategorisë C
D1E	23 vjeç	Merret, të paktën, 1 vit pasi të jetë marrë lejedrejtimi i kategorisë D1

D	24 vjeç	Merret, të paktën, 3 vjet pasi të jetë marrë lejedrejtimi i kategorisë C
DE	25 vjeç	Merret, të paktën, 1 vit pasi të jetë marrë lejedrejtimi i kategorisë D

b) të plotësojë kërkesat psiko-fizike

Certifikata Mjekësore vërteton që kandidati plotëson kërkesat psiko-fizike për të drejtuar mjete me motor.

c) të kryejë programin e plotë teorik dhe praktik për drejtues mjete në një autoshtetë, përveç kategorisë AM që merret vetëm me prove teorike

- Përgatitja teorike dhe praktike në një autoshtetë të autorizuar është e detyrueshme.
- Programi i përgatitjes teorike për lejedrejtimi të kategorisë A1, A2, B1, B, është i njëjtë;
- Programi i përgatitjes teorike për lejedrejtimi të kategorisë C1, C, është i njëjtë;
- Programi i përgatitjes teorike për lejedrejtimi të kategorisë D1, D, është i njëjtë.

** Të huajt duhet të kenë lejeqëndrimi të vlefshme kur kryejnë provat për drejtues mjete. Gjatë kryerjes së provave ata kanë të drejtën të marrin një përkthyesi të autorizuar.*

Në tabelën e mëposhtme tregohet kalimi nga një lejedrejtimi në një lejedrejtimi të një kategorie tjetër, programi i përgatitjes teorike (numri i temave, orëve, ditëve, pyetjeve, gabimeve të lejuara) dhe kohëzgjatja e testit, programi i përgatitjes së aftësive drejtuese e të sjelljes (numri i seancave, ditëve) dhe kohëzgjatja e provës së aftësive drejtuese e të sjelljes.

Tab. 05

KATEGORIA E LEJEDREJTIMIT EKZISTUES	KATEGORIA E LEJEDREJTIMIT QË KËRKOHET	PËRGATITJA TEORIKE						PËRGATITJA E AFTËSIVE DREJTUESE E TË SJELLJES		
		Nr. i Temave	Nr. i Orëve	Nr. i Ditëve	Prova teorike			Nr. i Seancave	Nr. i ditëve	Kohëzgjatja e provës praktike në minuta (')
					Nr. i pyetjeve	Kohëzgjatja e provës teorike në minuta (')	Nr. i Gabimeve të lejuara			
-	AM	10	-	-	30	30'	3	-	-	-
-	A1	25	36	15	40	40'	4	12	12	25'
-	A2	25	36	15	40	40'	4	12	12	25'
-	B1	25	36	15	40	40'	4	12	12	25'
-	B	25	36	15	40	40'	4	25	25	25'
AM	A1	25	26	8	40	40'	4	11	11	25'
AM	A2	25	26	8	40	40'	4	11	11	25'
AM	B1	25	26	8	40	40'	4	11	11	25'
AM	B	25	26	8	40	40'	4	20	20	25'
A1	A2	-	-	-	-	-	-	11	11	25'
A1	B1	-	-	-	-	-	-	11	11	25'
A1	B	-	-	-	-	-	-	15	15	25'
A2	A	-	-	-	-	-	-	11	11	25'
A2	B1	-	-	-	-	-	-	11	11	25'
A2	B	-	-	-	-	-	-	15	15	25'
A	B1	-	-	-	-	-	-	11	11	25'
A	B	-	-	-	-	-	-	15	15	25'
B1	A1, A2	-	-	-	-	-	-	11	11	25'
B1	B	-	-	-	-	-	-	15	15	25'
B	B96	-	-	-	-	-	-	11	11	25'
B	A1, A2	-	-	-	-	-	-	11	11	25'
B	C1	17	20	10	40	40'	4	11	11	45'
B	C	17	20	10	40	40'	4	15	15	45'
B	BE	-	-	-	-	-	-	11	11	25'
C1	C	-	-	-	-	-	-	7	7	45'
C1	C1E	-	-	-	-	-	-	7	7	45'
C	CE	-	-	-	-	-	-	7	7	45'
C	D1	2	4	3	10	10'	1	7	7	45'
C	D	2	4	3	10	10'	1	8	8	45'
D1	D	-	-	-	-	-	-	7	7	45'
D1	D1E	-	-	-	-	-	-	7	7	45'
D	DE	-	-	-	-	-	-	7	7	45'

d) të kryejë kursin e trajnimit për dhënien e ndihmës së shpejtë në rast aksidenti rrugor, kur pajiset me lejedrejtimi për herë të parë

Kur aplikoni për tu pajisur me lejedrejtimi për herë të parë, kursi i trajnimit për dhënien e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor, është i detyrueshëm. Ky kurs trajnimi

kryhet nga Kryqi i Kuq Shqiptar dhe pas përfundimit të tij lëshohet një Dëshmi për dhënien e ndihmës së shpejtë.

e) të fitojë provat për drejtues mjete (provën teorike dhe/ose provën e aftësive drejtuese e të sjelljes) për kategorinë e kërkuar

➤ Prova teorike

Prova teorike bëhet në formë elektronike, me anë të kompjuterit.

Në tab. 05 tregohet për çdo kategori lejedrejtimi, numri i (temave, seanceve, ditëve, pyetjeve, gabimeve të lejuara) dhe kohëzgjatja e testit (provës).

➤ Prova e aftësive drejtuese e të sjelljes

Mjetet që përdoren për provat e aftësive drejtuese e të sjelljes janë në përputhje me kriteret minimale të dispozitave të Aneksit II të Direktivës 2006/126/EC “Mbi lejet e drejtimit”.

Drejtimi i një mjeti me kuti shpejtësie manuale bëhet pas fitimit të provës së aftësive drejtuese e të sjelljes me një mjet me kuti shpejtësie manuale.

Drejtimi i një mjeti me kuti shpejtësie automatike bëhet pas fitimit të provës së aftësive drejtuese e të sjelljes me një mjet me kuti shpejtësie automatike, në këtë rast në lejedrejtimi shënohet kodi 78 përbri kategorisë.

Prova e aftësive drejtuese e të sjelljes për kategoritë A1, A2 dhe A

- Përgatitja dhe kontrolli teknik i motomjetit me qëllim sigurinë rrugore;
- Manovra të veçanta për t’u testuar me qëllim sigurinë rrugore;
- Sjellja në trafik.

Prova e aftësive drejtuese e të sjelljes për kategoritë B, B1 dhe BE

- Përgatitja dhe kontrolli teknik i automjetit me qëllim sigurinë rrugore;
- Kategoritë B dhe B1: Manovra të veçanta për t’u testuar me qëllim sigurinë rrugore;
- Kategoritë BE: Manovra të veçanta për t’u testuar me qëllim sigurinë rrugore;
- Sjellja në trafik.

Për kategorinë B, aplikantët duhet të kryejnë 6 (gjashtë) orë ushtrim praktike të detyrueshme, përkatësisht:

- 2 orë lëvizje në kushte të natës, në rrugë urbane të ngushta dhe të gjera ku ka mjete të parkuara anash ose jo, në kryqëzime të rregulluara me sinjale vertikale dhe impiante

semaforike;

- 2 orë lëvizje në rrugë urbane ose në rrugë interurbane dytësore, duke shfrytëzuar mjetin në regjime të ndryshme të punës së motorit, në regjimin e momentit përdredhës maksimal dhe duke shfrytëzuar konsumin minimal të karburantit;
- 2 orë lëvizje në autostradë ose rrugë interurbane kryesore apo dytësore duke e kaluar shpejtësinë 50 km/orë, duke përdorur 5 marshe dhe marshin më të përshtatshëm të shpejtësisë gjatë lëvizjes.

Prova e aftësive drejtuese e të sjelljes për kategoritë C, CE, C1, C1E, D, DE, D1 dhe D1E

- Përgatitja dhe kontrolli teknik i automjetit me qëllim sigurinë rrugore;
- Manovra të veçanta për t'u testuar me qëllim sigurinë rrugore;
- Sjellja në trafik.